



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-klina.org](http://www.komuna-klina.org)

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Nr. 320-38552/19

Klinë, me 11.11.2024

### Projekti komunal për përkrahjen në zhvillimin e Bletarisë

Projekt komunal për përkrahjen e bletarisë (furnizim me koshere dhe pajisje përcjellëse). Në kuadër të zhvillimit dhe përparimit të Bujqësisë –Bletarisë , Komuna e Klinës, respektivisht Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, bënë :

## THIRRJE PUBLIKE

Ftohen fermerët e interesuar për të aplikuar në projektin - furnizim me koshere për blete dhe pajisje përcjellëse.

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në këtë projekt do të kontribuoj :

- Me 70 % të koston se koshereve me pajisje përcjellëse, ndërsa fermëri me 30%
- Dhënia e këshillave profesionale përmes eksperteve të saj.

### Kriteret e konkurrimit:

1. Fermeri te jete banor i komunës së Klinës;
2. Të posedoj bletë;
3. Të jetë i gatshëm që të merr pjesë me 30 % te mjeteve financiare ne koston e koshereve për bletë dhe pajisjeve përcjellëse ;
4. Përparësi kanë fermerët të cilët nuk kanë përfituar ne tri vitet e fundit nga lëmia e bletarisë.


### Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

1. Kërkesa e plotësuar nga fermeri, e cila merret ne zyrën pritëse ne hyrje te objektit te komunës
2. Kopja e Certifikatës se NIF-it ( fermeri është i obliguar qe ne koshere te bletëve ta këtë të shkruar numrin e NIF-it)
3. Certifikata e vendbanimit
4. Certifikata e bashkësisë familjare
5. Kopja e letërnjoftimit

Afati i aplikimit është nga data 11.11.2024 deri me datën 22.11.2024.

Dorëzimi i dokumentacionit behet ne zyrën pritëse në hyrje të objektit të komunës.  
Dokumentet e pa kompletuara dhe te dorëzuara pas afatit nuk do te shqyrtohen.

**Vërejtje :** Nëse te dhënat e deklaruara ne kërkesën për aplikim nuk përputhen me gjendjen faktike ne teren nga komisioni, aplikuesi do te sanksionet me minus **10 pikë**.



Drejtori i Drejtorisë së BZHR

Lorenc Marleku